



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KURBIN**

Nr. 285/2 Prot

Laç më 30/11/2024

VENDIM

Nr 04 Datë 25/01 /2024

**PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERESIMEVE DHE PARASHIKIMEVE AFATMESME TË
TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË KURBIN PËR VITET 2025-2027**

Mbështetur në:

Ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika1/1.3, gërma ”b”, neni 35, pika 4, neni 54, gërma ”f”; Ligjin nr.68/2017 ”Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligjin nr.9632 dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 5, gërma ”b”, ”c” dhe ”ç”, neni 7, neni 9 ; Ligjin nr.9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr.9975 ” Për Taksat Kombëtare ”, i ndryshuar; Ligjin nr.115/2014 ” Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, legjislacionin e aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara, si dhe në zbatim të V.K.B-së nr. 27 datë 23.11.2023 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2024”, Këshilli Bashkiak Kurbin

V E N D O S I

Të miratojë Planin Afatmesëm të të Ardhurave Vendore për vitet 2025-2027.

investimet mbi kapitalet, të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga Bashkia, të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi, të ardhurat nga partneritetet publik - privat, etj.

Bashkia Kurbin parashikon të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, interesat, gjobat, kamatvonesat etj. Të ardhurat nga burime të tjera përbëjnë në total vetëm 8.4% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Pjesë e rëndësishme në këtë kategori zënë të ardhurat nga kamatvonesat dhe gjobat, nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë, si dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme.

Të ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar. Bazuar në nenin 6, pika b) "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të Këshillit Bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta". Bazuar në Nenin 10, masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Të ardhura të tjera

Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit etj. Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit etj.

Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

- >Prefektit të Qarkut Lezhë
- >Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore
- >Drejtoria e Financës
- >Arkivi

SEKRETARI I KËSHILLIT
Arbër LEKA



KRYETARE E KËSHILLIT
Edlira LLESHI

